



REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr Prot
Dep: 2-D/DPK	01-451/16
Dep:	Prot No
Nr. i rreg.	Data
Broj. stranica	Datum
Nr. pages	Date
02	05-02-2016
PRISHTINE	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 05.02.2016, mori:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-4304/15, për zyrtarin e lartë z. Isak Musliu, Këshilltar Komunal në Komunën e Shtimes, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur situatën e konfliktit të interesit .**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-02-4304/15, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Isak Musliu, Këshilltar Komunal në Komunën e Shtimes .**

Gjatë procesit për identifikimin e rasteve të dyshuara për konflikt të mundshëm të interesit, është identifikuar rasti për zyrtarin e lartë z. Isak Musliu, Këshilltar Komunal në Komunën e Shtimes.

Është vërejtur se zyrtari i lartë ka të regjistruar dy biznese private dhe figuron si person i autorizuar në këto biznese, e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin të funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 24.11.2015 e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese z.Isak Musliu,ka ardhur ne zyrat e AKK-se dhe nga zyrtarët e ngarkuar me rastin është njoftuar për situatën në të cilën gjendet si dhe me faktet dhe provat qe disponon AKK-ja.

Gjatë takimi me zyrtarin e lartë ai është pajtuar me gjendjen dhe është zotuar se do të mundohet që brenda afatit ligjor do të sjell dëshmitë qe është shmangur nga situata e mundshme e konfliktit të interesit .

Ne ndërkohë z. Isak Musliu ka sjell dokumentin zyrtar të lëshuar nga ARBK-ja, ku dëshmohet se Isak Musliu ka hequr dorë nga e drejta e ushtrimit të funksionit të personit të autorizuar biznesi më emër N.SH “SHQIPONJA-SH” me numër biznesi 70808609, ndërsa na ka njoftuar se tek biznesi me emër N.H“ Pamvarsia” ku është si pronar dhe person i autorizuar e ka pas të pamundur ti bej ndryshimet pasi qe ky biznes nuk ka pas numër fiskal dhe nuk ka ushtruar aktivitet dhe te dhënat për këtë biznes mungojnë, por do të bej përpjekje qe te bej ndryshimet dhe të shmanget nga situata e konfliktit te interesit.

Agjencia kundër Korrupsionit duke parë qe zyrtari nuk ka sjell dokumentet dhe çështja po zvarritet i ka bër edhe shkresën e dytë, dhe i kemi dhënë afat sipas nenit18.8 e Ligjit Nr.04/L-051.

Ne ndërkohë kemi pranuar dokumentin zyrtar të lëshuar nga ARBK-ja, ku dëshmohet se ne biznesin me emër N.H“ Pamvarsia” me numër 70558726 z. Isak Musliu, nuk figuron me si person i autorizuar i këtij biznesi.

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga zyrtari i lartë z. Isak Musliu, Këshilltar Komunal në Komunën e Shtimes, dukë ber ndryshimet në bizneset e tij private dhe duke u larguar nga personi i autorizuar ne bizneset e lartë cekura janë krijuar rrethana të reja dhe konstatojmë se është shmangur gjendjen e mundshme e konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë ne ushtrimin e funksionit publik, dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues )

Hasan Preteni  
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

